

**Pyetje/Përgjigjet për Skemën e Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2020“
Masa 8 (Lot I dhe Lot II)**

1. Nëse kompania ka 5 punëtorë ndërsa ka qarkullim mbi 500 mijë Euro, a ka te drejt te aplikoj për Lot 2 për vlerën 15,000 Euro ?
 - *Përcaktues për Lot është qarkullimi për vitin 2019, kurse nr. i punëtorëve të ndërmarrjeve duhet të jetë i klasifikuar si Mikro dhe ndërmarrje të vogla, në rastin konkret Ndërmarrja me nr. prej 5 punëtorëve ka të drejtë të aplikoj në Lot 2 bazuar në qarkullimin e paraqitur.*
2. Pyetje për grantin; tek udhëzimet për aplikim tek pika; 1.5 Shumat e granteve, thuhet; “ Çdo grant i kërkuar sipas kësaj Thirrjeje për Propozime duhet të jetë brenda shumave vijuese minimale dhe maksimale:..., Loti 2–Ndërmarrjet mikro dhe të vogla Nga 7,001.00€ deri në 15,000.00€
Pyetja e parë e jonë është; ju lutem na tregoni se ne si kompani a duhet që komplet vlera e projektit të jetë maksimal 15,000.00€, apo 15,000.00€ të jetë vlera e kërkuar nga ministria në fjalë?
 - *Vlera maksimale e kërkuar nga MZHR mund të jetë 15.000.00€ për Lot 2.*
3. Pyetja e dytë është në lidhje me përqindjen e bashkëfinancimit nga aplikantët e cila duhet të jetë nga 10% deri 40%, p.sh. A duhet ta llogarisim shumën 15,000.00€ plus shuma maksimale prej 40%, apo 15,000.00€ minus shuma maksimale 40%?
 - *Shuma e bashkëfinancimit duhet të jetë brenda 10-40% d.m.th vlera e grantit + bashkëfinancimi = shuma totale e Projektit.*
4. Pyetja e tretë; tek udhëzimet për aplikantët e grantit faqe nr. 4 thotë citoj;”... Shuma që kërkohet nga Autoriteti Kontraktues nuk mund të jetë nën 60% e kostos totale të projekt propozimit...”. A mund të jetë ky 60%, shuma maksimale e grantit prej 15,000.00€, plus 40% i vlerës së mbetur?, ju lutem na e sqaroni pak këtë paragraf se cila është shuma prej 60% e kostos totale?
 - *Udhëzuesit lidhur me kriteret për aplikantët e granteve % e grantit nga MZHR dhe bashkëfinancimin janë të sqaruara në pika 1.5.*
 - *P.sh:*
 - *LOT 1, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 778.00 (10%) + kontributi i MZHR-së 7,000.00 (90%) = 7,778.00 vlera totale e projektit*
maksimumi i bashkëfinancimit 4,666.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 7,000.00 (60%) = 11,666.00 vlera totale e projektit
 - *Loti 2 - minimumi i bashkëfinancimit 1,666.00 (10%) + kontributi i MZHR-së 15,000.00 (90%) = 16,666.00 vlera totale e projektit*
maksimumi i bashkëfinancimit 10,000.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 15,000.00 (60%) = 25,000.00 vlera totale e projektit
5. Kategorizimi i ndërmarrjeve në Lot 1 dhe Lot 2, bëhet nga numri i punëtorëve apo nga qarkullimi i deklaruar në ATK për vitin e fundit fiskal?
 - *Kategorizimi i ndërmarrjeve për L1 dhe L2 bëhet duke u bazuar në qarkullimin e vitit të fundit fiskal 2019, por gjithashtu duhet të jeni ndërmarrje mikro ose e vogël siç është e specifikuar në pikën 1.4 të udhëzuesit për aplikantë.*

6. Kompania jonë ka disa aktivitete, aktiviteti primar është ndërtimi (aktiviteti me kod 4120) ndërsa sekondar projektimi (aktiviteti me kod 7112). Në periudhën e fundit kompania jon merret kryesisht me shërbimin sekondar (aktiviteti me kod 7112). A lejohet pjesëmarrja jonë në aplikim për grante? (Për sqarimin e mëtutjeshëm të kësaj pyetje gjeni të bashkangjitur në attach certifikatën e biznesit).
 - *Referoju Udhëzuesit lidhur me kriteret për aplikantët e granteve konkretisht paragrafit të fundit të pikës 2.3.*
7. Kam qenë përfitues i Grantit ne vitin 2019.A kam te drejt te aplikoj ne "Programi për rimëkëmbje Ekonomike 2020, Masa 8"
 - *Të gjithë përfituesit skema PZHRB 2018, 2019 dhe 2020 nuk kanë të drejtë aplikimi për këtë thirrje.*
8. A kane te drejte aplikimit kompanitë qe kane fituar grantin nga MZHR, pasi nuk shkruan ne udhëzimin?
 - *Paragrafi i fundit i pikës 3.1 e Udhëzuesit lidhur me kriteret për aplikantët e granteve ndër të tjera thotë:
(pronarët e bizneseve që kanë përfituar) nga skema PZHRB 2018, PZHRB 2019 dhe PZHRB 2020 nuk kanë të drejtë aplikimi për këtë thirrje.*
9. Ju lutem për sqarim, ne listën e dokumenteve për aplikim kërkohet "Deklarata vjetore e qarkullimit e raportuar ne ATK" ne si biznes individual, jemi veprimtari shërbyese dhe ne kemi deklarim vetëm në tremujore TM1,TM2,TM3,TM4, (forma e tatimit me bruto qarkullim x 9%) dhe nuk kemi obligim ligjor me dorëzua deklaratën vjetore ne ATK.
Pyetja ime: Ne mungesë të deklaratës vjetore, a duhet të dorëzojmë raportet TM1, TM2, TM3, TM4 /2019 për të dëshmuar qarkullimin apo si te veprojmë ne këtë rast.
 - *PO ju mund ti dorëzoni 4 raportet/formularët e TM1, TM2, TM3, TM4 për v.2019 (me shkurtesën IS për Biznese individuale apo QS për korporata).*
10. Ju e keni përjashtuar sektorin e ndërtimtarisë për te përkrahur, por ky sektor ngërthen ne vete shume veprimtaria. Desha te ju pyes, a lejohet përkrahja për veprimtarinë me kod 2223 Prodhimi i artikujve te plastikes për ndërtimtari, respektivisht prodhimi i dyerve dhe dritareve nga PVC dhe AL.
 - *Përgjigjen e gjini në piken 2.3 Sektorët apo temat tek Udhëzuesit lidhur me kriteret për aplikantët e granteve, ku ndër të tjera thuhet:
Ndërmarrjet që operojnë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve, si dhe në shërbimet komerciale janë të kualifikuara të aplikojnë. Interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet, dhe të krijojnë eksporte që mbulojnë nevojat dhe prioritetet e mjedisit lokal.*
11. Se a kane te drejte edhe bizneset jo prodhuese, p.sh. klinikat laborante ose bizneset transportuese.
 - *Pyetja është shumë e përgjithësuar, gjithsesi ju këshillojmë të lexoni Udhëzuesi lidhur me kriteret për aplikantët e granteve, konkretisht piken 2.3 të këtij Udhëzuesi.*
12. E kemi një biznes qe merremi automekanike, auto elektrikë, vullkanizer dhe autolimar. Ne synojmë qe te rrisim produktivitetin tonë në biznes.
A na lejohet te aplikojme ne thirrjen e MZHR, pra a hynë në fushën e programit?

- Përgjigjen e gjini në piken 2.3 dhe 2.5 tek Udhëzuesi lidhur me kriteret për aplikantët e granteve, ku ndër të tjera thuhet: Ndërmarrjet që operojnë në shërbime janë të kualifikuara të aplikojnë

13. Nuk e kam shumë të qartë sa duhet të participoj aplikuesi? çfarë nënkuptojmë me kontributin në natyrë dhe sa është përqindja financiar MZHR-se.

- Aplikanti ka mundësi participimi prej 10 – 40 % shiko shembullin e ilustruar në fund të përgjigjeve.*
- Një kontributi në natyrë është një kontribut i një të mire apo një shërbimi tjetër përveç parave.*

14. Jemi kompani me qarkullim mbi 50,000 euro me 7 punëtorë, a mundemi me apliku në Lot 2?

- Po ,keni të drejt aplikimi.*

15. Dua te ju pyes ne lidhje me grantin nga MZHR-ja

Se a kane te drejte edhe bizneset jo prodhuese, p.sh. klinikat laborante ose bizneset transportuese ?

- Përgjigjen e gjini në piken 2.3 dhe 2.5 tek Udhëzuesit lidhur me kriteret për aplikantët e granteve,*

Sqarim lidhur me plotësimin e buxhetit:

Shtojca B1 PZHRB 2020 "Programi për Rimëkëmbje Ekonomike 2020, Masa 8" (Lot 1 dhe Lot 2 Biznes ekzistues)					
I. Buxheti për veprimin 1 (Tabela A)					
Nr.	Shpenzimet	Njësia	# i njësive	Vlera e njësive (në EUR)	Shpenzimet e përgjithshme (në EUR)
1	1. Pajisjet dhe furnizimet				
1.1	Pajisja XXXXX	copë	1	€ 17,000.00	€ 17,000.00
1.2					€ -
1.3					€ -
1.4					€ -
Shpenzimet e nën kategorisë: pajisje dhe furnizime					€ 17,000.00
2	2. Shpenzimet e tjera, shërbimet				
2.1					€ -
2.2					€ -
2.3					€ -
2.4					€ -
Shpenzimet e nën kategorisë: të tjera, shërbime					€ -
3	3. Të tjera				
3.1					€ -
Shpenzimet e nën kategorisë: të tjera					€ -
Gjithësej shpenzime direkte të kualifikueshme për veprimin (1-3)					€ 17,000.00
II. Burimet e pritura të financimit dhe përmbledhja e shpenzimeve të parapara (Tabela B)					
				Shuma	Përqindja
				EUR	%
Burimet e pritura të financimit					
Kontributi i MZHR-së i kërkuar me këtë aplikacion (A)				15000	
Kontributet tjera (aplikanti, donatorët tjerë, etj.)					
Kushtet				2000	
KONTRIBUTET TOTALE të pritura (B)				€ 17,000.00	
Shpenzimet e parapara					
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME TË KUALIFIKUESHME të parapara (B)				€ 17,000.00	
Kontributi nga MZHR e shprehur si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të kualifikueshme (A/B x100)					88.24
Sqarim 1: Përshkrimi i njësive duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar dhe të gjitha njësitë duhet të jenë të zbërthyera në përbërësit e tyre kryesor. Numri dhe vlera e njësive duhet të specifikohet për secilën njësi varësisht nga treguesi i ofruar. Buxheti duhet të përfshijë shpenzimet e lidhura me veprimin si tërësi, pavarësisht pjesës nga MZHR. Sqarim 2: Në rast të mospërputhjes së vlerave në mes të Tabelës A dhe të Tabelës B projekti diskualifikohet Sqarim 3: Përfituesi (it) është përgjegjës për korrektesinë e informatave financiare të ofruara në këtë tabelë.					

Kontributi i MZHR-së i kërkuar

Kontributi i aplikantit

Vlera totale e projektit duhet të jetë e njëjtë me vlerën e tabelës A

Përqindja e financimit nga granti prej MZHR-së